



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONA VE/NDERTIMEVE INFORMALE

**RAPORT  
I ANALIZËS SË VEPRIMTARISË PËR VITIN 2017**

**ALUIZNI**

**AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË  
ZONA VE/NDERTIMEVE INFORMALE**

## PERMBAJTJA

### BILANCI I VEPRIMTARISË

- A. TREGUESIT E LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE.
- B. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE
- C. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCESIN E LEGALIZIMIT.
- Ç. SITUATA FINANCIARE, ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.
- D. VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM.

## BILANCI I VEPRIMTARISË

### A.TREGUESIT E LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE.

#### 1. Të dhënat e aplikimeve për legalizim dhe ndërtimeve që përjashtohen nga procesi.

Pas përfundimit të fushatave të aplikimit për legalizimin e ndërtimeve pa leje (ajo e vitit 2014 dhe 2015), nga struktura e përpunimit të të dhënave, u bë e mundur rezultatja e një shifre përfundimtare të ndërtimeve informale në territorin e Republikës. Kjo rezultante u llogarit si diferencë e numrit të aplikimeve për legalizim, me dublikimet (përsëritjet) e aplikimeve disa herë për të njëjtin ndërtim pa leje, të cilat janë **në nivelet 25-30% të numrit të përgjithshëm të aplikimeve.**


Mbi bazën e një studimi analitik të bërë për cdo qark, është vlerësuar se nga numri i përgjithshëm i ndërtimeve të përfshira në proces, një kontigjent prej **95.131 ndërtimesh**, nuk mund të vijojnë procedurat momentalisht, (me legjislacionin aktual), pasi nuk plotësojnë kriteret për t'u legalizuar.

*Tabela 1* paraqet numrin total të aplikimeve për legalizim sipas viteve, numrin e përgjithshëm të ndërtimeve që përjashtohen nga legalizimi, si dhe numrin e përgjithshëm të objekteve që plotësojnë kriteret për legalizim..

DREJTORIA	NUMRI I APLIKIMEVE SIPAS VITEVE						NR. I OBJEKTEVE QE NUK LEGALIZOHEN	NR. I OBJEKTEVE TE LEGALIZUESHEM
	2005	2006	2013	2014	2015	TOTAL		
BERAT	2.249	5,092	519	8,077	477	11,490	1,693	9.797
DIBËR	65	1,410	181	2,299	283	2,967	108	2.859
DURRËS	13.323	25,183	4,574	24,737	5,400	51,189	9,795	41.394
ELBASAN	6.808	12,984	3,755	22,287	1,202	32,925	226	32.699
FIER	2.556	25,992	1,934	24,863	1,413	39,731	9,805	29.926
GJIROKASTËR	190	1,738	199	2,660	513	3,710	352	3.358
KORÇË	3.828	6,114	1,034	6,392	787	12,709	8,216	4.493
KUKËS	201	1,819	181	1,452	193	2,692	747	1.945
LEZHË	2.701	8,519	2,357	8,910	1,177	16,565	4,042	12.523
SHKODËR	1.527	16,566	2,691	13,031	1,322	24,596	1,993	22.603
VLORË	6.696	16,730	2,498	10,795	1,272	26,594	10,925	15.669
TIRANË	23.946	64,795	4,131	36,990	10,018	97,916	47,229	50.687
<b>TOTAL</b>	<b>64.000</b>	<b>186,942</b>	<b>24,054</b>	<b>162,493</b>	<b>24,057</b>	<b>323,082</b>	<b>95,131</b>	<b>227.951</b>

Grafiku i aplikimeve per legalizim

**Aplikimet per legalizim sipas Qarqeve  
2005-2015**



**2. Procedurat e përditësimit në terren dhe hartimi i dokumentacionit teknik.**


Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017 është kryer evidentimi faktik në terren për **60.061** ndërtime pa leje. Si një ndër procedurat kryesore, ajo përfshin përditësimin në terren të gjendjes faktike ndërtimore të objektit dhe plotësimin e hartimin i dokumentacionit tekniko-ligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj.).

Ky tregues i rëndësishëm për finalizimin e procedurës së legalizimit, ka njohur rritje nga viti në vit dhe tashmë, me objektet e evidentuara **gjatë vitit 2017**, kjo procedurë **ka përfunduar për mbi 97%** të ndërtimeve informale, të përfshira në procesin e legalizimit.

Në vijim paraqitet në formë tabelare dhe grafike ecuria në vite e këtij treguesi.

Tabela 2

2006-2013	EVIDENTIMI NE TERREN					2014-2017	TOTAL
	2014	2015	2016	2017			
46.037	64.138	74.510	71.124	60.061	<b>269.833</b>	<b>315.870</b>	



### 3. Lejet e legalizimit

Në kuadër të mirë përcaktimit të një seti procedurash dhe afatesh konkrete, gjatë vitit 2017, u bë i mundur përshpejtimi i ritmeve të procesit, duke legalizuar **26,451 ndërtime**

Në një analizë krahasuese të performancës së Agjencisë gjatë tre viteve (2014-2017) numri i lejeve të legalizimit arriti në **114.844 (5 herë më shumë se 8 vitet e qeverisjes së mëparshme)** duke e çuar numrin e përgjithshëm të objekteve të legalizuara në **136.594**.


Treguesit janë premtues, duke patur parasysh se numri i pritshëm, i objekteve që do të pajisen me leje legalizimi (**diferenca midis “objekte të legalizueshme” dhe “leje legalizimi”**) deri në përfundim të procesit është vetëm **91.359 (tab.vijuese)**.

QARKU	NR. I OBJEKTEVE TE LEGALIZUESHEM	NUMRI I LEJEVE TE DHENA	NUMRI I OBJEKTEVE NE PROCES
BERAT	9.797	3,361	6,436
DIBËR	2.859	1,387	1,472
DURRËS	41.394	29,621	11,773
ELBASAN	32.699	11,856	20,843
FIER	29.926	17,085	12,841
GJIROKASTËR	3.358	2,147	1,211
KORÇË	4.493	3,750	743
KUKËS	1.945	1,371	574
LEZHË	12.523	8,285	4,238
SHKODËR	22.603	8,027	14,576
VLORË	15.669	10,132	5,537
TIRANË	50.687	39,572	11,115
<b>TOTAL</b>	<b>227.951</b>	<b>136,594</b>	<b>91,357</b>



Tabela 3 dhe grafiku në vijim paraqesin numrin e lejeve sipas viteve.

LEJE LEGALIZIMI SIPAS VITEVE									
2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	TOTAL
2.023	1.819	3.625	6.507	7.776	15.294	21.748	51.351	26.451	<b>136.594</b>




Ecurinë më të mirë, në legalizimin e ndërtimeve informale edhe gjatë vitit 2017, e kanë drejtoritë e ALUIZNI-t të qarkut **Tiranë, Durrës, Fier dhe Elbasan.**

QARKU	2006-2013	2014	2015	2016	2017	2014-2017	NUMRI I PERGJ.
BERAT	1.377	431	477	269	807	1.984	3.361
DIBER	317	46	173	508	343	1.070	1.387
DURRËS	2.728	3.386	5.885	12.917	4705	26.893	29.621
ELBASAN	2.071	1.553	1.007	4.671	2554	9785	11.856
FIER	1.708	2.698	2.443	6.323	3913	15.377	17.085
GJIROKASTËR	328	361	397	614	447	1.819	2.147
KORÇË	842	152	998	780	978	2.908	3.750
KUKËS	341	291	266	187	286	1.030	1.371
LEZHË	1.427	792	1.222	3.740	1104	6.858	8.285
SHKODËR	1.403	1.033	1.377	3.520	694	6.624	8.027
TIRANË	6.466	3.371	6.623	16.023	7089	33.106	39.572
VLORË	2.742	1.180	880	1.799	3531	7.390	10.132
<b>TOTAL</b>	<b>21.750</b>	<b>15.294</b>	<b>21.748</b>	<b>51.351</b>	<b>26.451</b>	<b>114.844</b>	<b>136.594</b>

Tabela e numrit të lejeve të legalizimit sipas qarqeve dhe viteve.

Paraqitje grafike e **performancës sipas qarqeve**, për sa i përket këtij treguesi, gjatë viteve.

Numri i lejeve sipas qarqeve per vitet 2006-2017



#### 4. Ndërtimet e përjashtuara nga legalizimi

Gjatë vitit 2017 janë kryer procedurat administrative të përjashtimit për **293 ndërtime**, të cilat nuk përmbushin kushtet për legalizim, sipas nenit 39 të ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin,...” dhe VKM nr.280/2014.

Në funksion të një tabloje të qartë të gjendjes së objekteve të kundraligjshme, për të cilat ka një vendimmarrje nga IKMT, në bazë të ligjit nr.9780/2007, “Për inspektimin e

ndërtimit”, i ndryshuar, ALUIZNI ka ndërmarrë iniciativën për përgatitjen e një informacioni të plotë dhe të saktë, mbi numrin e objekteve të prishura si të kundraligjshme, që janë përfshirë në procesin e legalizimit.

Në lidhje me këtë kontigjent ndërtimesh informale, nga Agjencia ka patur një iniciativë bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, duke parashikuar që familjet që kanë një banesë në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, të jenë subjekt dhe të përfitojnë nga lehtësitë, që parashikon legjislacioni për programet sociale të strehimit.

### **5. Kalimi i të së drejtës së pronësisë dhe kompensimi i pronarëve.**

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nga strukturat përgjegjëse në qarqe dhe Drejtoria e Cështjeve të Pronësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, është hartuar dokumentacioni i nevojshëm i cili ka rezultuar në miratimin nga Këshilli i Ministrave, vetëm gjatë vitit 2017 të:

- Kalimit të së drejtës së pronësisë për **3262 parcela ndërtimore**, të zëna nga ndërtimet pa leje;
- Ndryshimit, korigjimit të konfigurimit dhe sipërfaqes për **259 parcela ndërtimore**.
- Shpërblimit financiar të **695 subjekteve**, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje, me vlerë të përgjithshme prej **2.230.499.718,4** lekë.

## **B. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE**

Aktet normative të miratuara gjatë vitit 2017, të hartuara nga ALUIZNI dhe gjendja e projektakteve paraqiten në vijim.

### **Akte të miratuara.**

**1. VKM nr. 19, datë 11.1.2017** “Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien”.

**2. VKM nr. 368, datë 26.4.2017** “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje, me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”, të ndryshuar”.

**3. VKM nr. 320, datë 12.4.2017** “Për një ndryshim në vendimin nr. 828, datë 23.11.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë, pa pagesë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës”.

**4. 8 VKM periodike** “Për miratimin e kalimit të pronësisë të parcelave ndërtimore dhe kompensimin...”

## **C. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCESIN E LEGALIZIMIT.**



Një ndër objektivat e ALUIZNI-t gjatë vitit 2017 ka qenë intensifikimi i dhe rritja e nivelit të bashkërendimit me institucionet e përfshira në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale. Kjo përfshirje ka të bëjë qoftë me trajtimin efikas dhe në kohë, të një numri sa më të madh të objekteve informale, me problematika që lidhen me institucione të tjera, por edhe me zbatimin e angazhimit, për një proces legalizimi falas.

Përmendim këtu ndërveprimin me institucionet qendore, si:

-Ministria e Mbrojtjes,

-Ministria e Kulturës,

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

por në mënyrë të veçantë institucionet ligjzbatuese, si:

-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

-Agjencia e Trajtimit të Pronave,

-Instituti i Monumenteve të Kulturës,

-Enti Kombëtar i Banesave,

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj.

Në këtë drejtim, do të konsideronim si histori suksesi:

- aplikimin e skemës së faljes së pagesës së truallit për kategoritë në nevojë si personat me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e të verbërit, invalidit të punës, subjektete e ndihmës ekonomike etj.,
- trajtimin dhe përfshirjen në skemën e legalizimit të një numri familjesh të vendosura në objektet ish-ushtarake,
- bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacionit në procesin e vendimmarrjes për miratimin e zonave të mbrojtura mjedisore,
- nxitjen e banorëve të zonave informale për tu përfshirë në skemën e pagimit të energjisë elektrike, duke përdorur bonuse në vlerën e truallit të legalizuar,
- nisjen e procesit të unifikimit dhe korrigjimit të informacionit hartografik të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas hartës së fotografimit ajror dhe të përdorur nga ALUIZNI,
- mirëfunksionimin e skemës së shpërblimit financiar të pronarëve, pronat e të cilëve janë zënë nga ndërtimet informale.

Pavarësisht ecurisë së mirë, në termat e mësipërm, drejtoritë e varësisë të ALUIZNI kanë patur bashkëpunim të vështirë dhe jo rezultativ në drejtim të marrjes së informacionit të domosdoshëm, për të vijuar procedurat e legalizimit me Institucionet në vijim:

- Njësitë e Vetqeverisjes Vendore → në lidhje me vënien në dispozicion të informacionit mbi planet vendore të zhvillimit dhe projektet e vecanta të rikualifikimit urban.
- Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme → për vënien në dispozicion të informacionit mbi gjendjen juridike të truallit ku ngrihen ndërtimet pa leje, si dhe për kryerjen e procesit të regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të ndërtimeve të legalizuara.
- Autoriteti Rrugor Shqiptar → mbi dhënien e informacionit për kategorizimin e rrugëve sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor si dhe mbi kërkesat për përjashtim nga procedura e legalizimit të ndërtimeve informale, të pa argumentuara dhe të pa shoqëruara me projektet e miratuara.

- Hekurudha Shqiptare sh.a. → për mos dërgimin e informacionit mbi brezat mbrojtës dhe distancat nga linjat hekurudhore ekzistuese, sipas Kodit Hekurudhor.
- Bordet e Kullimit → lidhur me vendosjen në dispozicion të rrjeteve kryesore të kanaleve kulluese.
- Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike → lidhur me përfundimin e regjistrimit të pronave publike, dhe ndryshimin e statusit juridik të pronave publike në ZVRPP.
- Etj...

## Ç. SITUATA FINANCIARE, ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.

### **1. Planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i shpenzimeve publike.**

Aktivitetet kryesore të ndërmarra për arritjen e këtij objekti, gjatë vitit 2017, sipas fushave kryesore të buxhetimit, përmbledhen në:

#### **a) Në fushën e planifikimit buxhetor.**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të udhëzimit nr. 4, datë 29.02.2016, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019", dhe taveve të detajuara nga MZHUT, u përgatit programi buxhetor afatmesëm, PBA 2017-2019, si dhe projekt-buxheti për vitin 2018. Në vija të përgjithshme, kërkesat për PBA 2018-2020, janë hartuar dhe paraqitur konform procedurave standarte të përgatitjes së tyre. Për realizimin e detyrës së rëndësishme të planifikimit buxhetor, me urdher të titullarit të institucionit, u ngrit dhe funksionon grupi i menaxhimit strategjik të ALUIZNI-t.

Pas miratimit nga Kuvendi, i ligjit të buxhetit të vitit 2017, dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave, nga ana e Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, u bë detajimi i fondeve buxhetore, përgatitja e limiteve mujore (planit të arkës) sipas drejtorive të varesive të ALUIZNI-t, si dhe miratimi nga MZHUT dhe Ministria e Financave. E njëjta procedurë u realizua edhe për numrin e punonjësve, të miratuar për ALUIZNI-n në ligjin e buxhetit të vitit 2017. Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varesive të ALUIZNI-t, filluan vitin e ri buxhetor me fonde dhe numër punonjësish të miratuar në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore.

Në janar të vitit 2017, janë paraqitur të argumentuara në MZHUT dhe Ministrinë e Financave kërkesat për punonjës me kontratë të përkohshme, për drejtoritë e varesive dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej 714 punonjësish. Për nevojën e institucionit, u ndoq e njëjta procedurë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2017 duke u shtuar një kontigjent prej 100 punonjësish me kontratë, në varësi të arkëtimit të të ardhurave.

#### **b) Në fushën e menaxhimit dhe monitorimit të fondeve publike.**

Nga ana e Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse është bërë ndjekja periodike e realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2017, për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varesive të ALUIZNI-t. Në përmbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht, çdo 4-mujor, raportet e monitorimit të



shpenzimeve buxhetore, te cilat jane derguar ne MZHUT, sipas percaktimeve ne udhezimin e zbatimit te buxhetit te Ministrit te Financave.

Për vitin 2017, ALUIZNI administron dhe menaxhon fondet buxhetore, sipas dy programeve të miratuara e konkretisht:

- Shpenzimet
- Investimet Publike

Realizimi i pritshem i shpenzimeve operative "Mallra dhe sherbime", për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Planifikimi	Realizimi	%
1	Berat	2.294.000	2.211.607	96
2	Diber	3.892.055	3.827.133	98
3	Durres	2.800.000	2.799.353	100
4	Elbasan	2.800.000	2.788.247	99
5	Fier	3.764.576	3.726.760	99
6	Gjirokaster	2.438.938	2.303.808	94
7	Kavaje	1.000.000	633.092	63
8	Kruje	1.000.000	704.638	100
9	Korce	2.400.000	2.199.741	92
10	Kukes	1.800.000	1.799.194	100
11	Lezhe	2.200.000	2.080.424	94
12	Lushnje	1.200.000	644.342	77
13	Shkoder	3.582.900	3.424.816	96
14	Vlore	2.600.000	2.600.000	100
15	Sarande	2.073.805	2.006.073	97
16	Tirane Veri	3.994.280	3.994.280	100
17	Tirane Jug	2.600.000	2.581.155	99
18	Tirane2	1.816.550	1.456.224	74
19	Tirane Rurale	2.600.000	2.596.477	100
20	Zonat Turistike	1.200.000	739.679	61
21	Kamez Vore	2.760.000	2.594.838	94
22	D. Pergjithshme	20.859.406	20.208.919	97
	<b>TOTALI</b>	<b>71.676.000</b>	<b>67.930.531</b>	<b>95</b>

Shpenzimet operative faktike gjatë 12 mujorit te vitit 2017, jane realizuar në rreth 95% te fondeve te alokuara nga buxheti i shtetit.

Drejtoritë tona për "Shpenzime korente" kanë përdorur edhe fonde nga të ardhurat, të cilat i kanë ndihmuar në perballimin e shpenzimeve per te siguruar vazhdimësinë e procesit. Shpenzimet korente te perballuara nga te ardhurat jane sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Per Paga+ Sigurime shoqerore per punonjesit me kontrate	Per Mallra dhe sherbime
1	Berat	4.883.640	912.000
2	Diber	1.289.220	
3	Durres	19.065.106	293.998
4	Elbasan	22.132.741	3.338.108
5	Fier	18.204.040	143.980
6	Gjirokaster	4.074.986	
7	Kavaje	6.369.371	
8	Kruje	2.227.388	
9	Korce	6.871.837	1.262.206
10	Kukes	600.000	399.492
11	Lezhe	11.208.415	1.444.620
12	Lushnje	5.625.222	
13	Shkoder	8.082.616	
14	Vlore	19.770.409	4.039.959
15	Sarande	6.964.536	1.555.544
16	Tirane Veri	22.261.052	4.084.075
17	Tirane Jug	22.792.121	1.992.514
18	Tirane2	16.995.141	488.863
19	Tirane Rurale	14.351.999	1.571.466
20	Zonat Turistike	11.711.856	66.354
21	Kamez Vore	17.139.221	3.695.545
22	D. Pergjithshme		
	<b>TOTALI</b>	<b>242.621.367</b>	<b>25.288.724</b>

Brenda totalit të shpenzimeve të përgjithshme, shpenzimet “Mallra dhe sherbime”, që përfaqësojnë rreth 27 përqind të këtyre shpenzimeve, janë realizuar në rreth 95%, ndërkohë që shpenzimet për investime që përfaqësojnë rreth 12 % të tyre, janë realizuar në 53 %.

Sipas zërave përbërës të tyre, shpenzimet korente janë realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Artikulli	Emërtimi	Buxheti 2017			Buxheti/Te Ardhura	
		Plan	Fakt	Në %	Fakt	
600	Shpenzime personeli Paga	409.604.5	398.900	97.40	242.621	600+601
601	Shpenzime personeli-sig.shoq.	78.595.8	69.350.7	88.5		
602	Shpenzime operative	71.676	67.931	95	25.288.7	
603-606	Të tjera shpenzime korrente	163	163	100		
	Shpenzime korente	<b>480.720</b>	<b>467.257</b>	<b>97</b>	<b>267.910</b>	



Zëri investime është realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Planifikimi	Realizimi i pritshem	%
1	Berat	1.200.000	1.039.080	870
2	Diber	960.000	261.600	28
3	Durres	1.158.000	0	0
4	Elbasan	1.440.000	1.371.600	95
5	Fier	1.200.000	1.200.000	100
6	Gjirokaster	1.200.000	918.240	96
7	Kavaje	1.200.000	1.200.000	100
8	Kruje	1.200.000	849.312	70.7
9	Korce	1.320.000	1.263.240	96
10	Kukes	960.000	954.000	99
11	Lezhe	1.200.000	1.192.200	99
12	Lushnje	1.140.000	584.160	51
13	Shkoder	1.200.000	1.137.246	95
14	Vlore	1.200.000	1.130.040	94
15	Sarande	1.200.000	1.130.800	
16	Tirana Veri	1.200.000	1.132.584	94
17	Tirane Jug	1.200.000	1.030.320	86
18	Tirana Rurale	1.920.000	1.505.201	78
19	Zonat Turistike	1.200.000	1.127.280	95
20	Kamez-Vore	1.323.600	1.283.952	97
21	Drejtoria Pergjithshme	49.778.400	20.829.314	42
	<b>TOTALI</b>	<b>75.600.000</b>	<b>40.171.049</b>	<b>53.1</b>

Per nje ndjekje dhe menaxhim me te mire te shpenzimeve e ne vecanti te investimeve, u është kerkuar drejtorive te varesise raportim mujor te performances se shpenzimeve te tyre buxhetore, duke evidentuar edhe fazat e vecanta ne te cilat ndodhet shpenzimi.

Nga analiza e shpenzimeve buxhetore **sipas programeve** rezulton:

➤ Shpenzimet korente sipas klasifikimit ekonomik rezultojne ne keto nivele realizimi per vitin 2017:

1. Shpenzimet per paga 97 %
2. Shpenzimet per sigurimet shoqerore 97 %
3. Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes 98.6 %
4. Shpenzimet per transferta tek individet 100 %

➤ Investimet publike me financim të brendshem per Programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, në buxhetin e vitit 2017 ne vleren 234 milione leke u shpërndanë në 5 projekte si më poshtë:

1. Blerje paisje elektronike, me vlerë 64.282 milionë lekë, u propozua per tender të hapur nga Ministria e Brendshme, ne shumen 26.737,500 leke dhe u autorizua per lidhje kontrate 19.659.628 leke te cilat jane obliguar dhe jane duke u realizuar. Per drejtorite e vartese u alokuan 20.160.000 leke per tu realizuar me

proceduren "Blerje e vogel". Nga te gjitha drejtorite e varesise ne keto shpenzime per investime per 16.715.000 leke ne masen 83%.

2. Blerje pajisje zyre me vlerë 6.318 milionë lekë, u realizua me proceduren "Blerje e vogel" nga te gjitha drejtorite e varesise i realizuar në masën 76.3%.

3. Shtese kati ne godinen e Drejtorise se Pergjithshme eshte realizuar vetem vleresimi i gjendjes ekzistuese te godines per 816 mije leke ,ne masen 16.3%.

Perdorimi i fondit te vecante, për vitin 2017 është bërë ne perputhje me kriteret e percaktuara ne vendimet perkatese te perdorimit te tij, si dhe eshte dhene pergjigje institucioneve te varesise per problematika te vecanta te ngritura nga ana e tyre.

Nga ana e ALUIZNI-t, gjatë vitit 2017, jane ndjekur te gjitha procedurat e percaktuara ne ligjin e menaxhimit financiar per miratimin e nepunesve autorizues dhe zbatues te drejtorive të varësisë sipas nevojave të tyre.

Gjatë 12 mujorit te vitit 2017 ka realizuar të ardhura nga procesi i legalizimit sipas tabelës më poshtë vijon:

DREJTORIA	Vlera e Parceles ndertimore	Arketime nga tarifa e sherbimit	Arketime nga penalitete
Berat	9,801,094	3,016,000	4,639,562
Diber	1,785,236	1.338.000	3,810
Durres	163,966,460	7,456,000	11,949,558
Elbasan	96,638,362	9,258,000	701,683
Fier	32,463,616	5.024,000	1,227,983
Gjirokaster	8,476,070	1,632,000	-
Korce	5,288,916	3,696,000	11,217,937
Kukes	6,608,250	352,000	55,021
Lezhe	16,919,500	4,752,000	3,733,550
Lushnje	9,692,169	1,534,669	3,341.694
Shkoder	25,975,687	808,000	244,186
Sarande	59,170,844	6,858,800	13,316,717
Vlore	212,564,551	5,024,000	9,360,873
Tirane Veri	225,840,274	1,694,400	814,978
Tirane 2	16,340,100	4,556,667	21,927,252
Tirane Rurale	7,632,569	7,680,000	13,781,761
Zona Turistike	31,307,288	3,367,729	3.798.637
Kamez-Vore	92,667,694	3,637,006	5,266,044
Tirana jug	143,530,957	2,544,000	4,270,207
Kruje	5,246,222	1,370,953	1,553,239
Kavaje	22,487,580	1,904,000	616,354
<b>TOTALI</b>	<b>1,194,403,441</b>	<b>77.502,224</b>	<b>111,821,047</b>

Gjatë këtij viti janë transferuar në fondin e kompensimit të pronarëve **838.955.896 lekë**. Nga të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndërtimore të objekteve pa leje, jane transferuar ne buxhet 170.000.000 leke te akorduara per paga e sigurime

shoqerore per punonjesit me kontrate. Jane shpenzuar nga drejtorite e varesise per paga, sigurime shoqerore e shpenzime operative 267.910.091 leke, si dhe jane derdhur ne buxhet te ardhura te paperdorura ne vlere 276.860.745 lekë.

Në vitin 2017 eshte punuar ne cdo drejtori per arritjen e objektivave te vendosura ne PBA, pune e cila ka cuar ne tejkalimin e tyre, ku **nga 1 miliard leke** te caktuara ne objektivat tona per arketimet nga vlere e parceses ndertimore **jane realizuar 1.194.403.441 leke**, nga **700.000.000 leke** te caktuara ne objektivat tona per tu derdhur ne buxhet u arrit ne shifren prej **838.955.896 leke**, te cilat perdoren per fondin e kompensimit te pronareve.

## **2. Organizimi i brendshëm.**

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, gjatë vitit 2016, është riorganizuar me Urdhrin nr.58, 05.04.2016 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe drejtorive në varësi të saj", me fokus kryesor:

- Rritjen e efikasitetit të strukturave, në funksion të përsheptimit të procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje,
- Shkurtimin e shpenzimeve buxhetore të tepërta nëpërmjet rekrutimit të specialistëve me profilin e duhur arsimor
- Transferimin e shërbimit sa më pranë qytetarit duke shpërndarë në territor një numër të konsiderueshëm ekspertësh.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të ALUIZNI-t, për vitin 2017, sipas strukturës së miratuar rezulton 315 vetë nga 299 që ishte në gjysmën e parë të vitit të kaluar.

ALUIZNI ka raportuar pranë institucioneve përkatëse për të dhënat lidhur me burimet njerëzore, emërimet, lirimet, masat disiplinore dhe vendimet gjyqësore që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Për periudhën janar-dhjetor 2017 Institucioni në respektim të dispozitave të Kodit të Punës, për punonjësit e strukturës dhe ata me kontratë të përkohshme, ka dhënë gjithsej 143 masa disiplinore, nga të cilat 50 "Vërejtje", 45 "Vërejtje me shkrim", 33 "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" dhe 15 "Tërheqje vëmendje".

## **3. Infrastruktura dhe ambientet.**

Ka mungese te hapësirave ne godinen e Drejtorise se Pergjithshme. Vlen te permendet se ne Arkivit qendror, nuk jane depozituar dosjet e ndertimeve informale te pajisura me leje legalizimi qe nga viti 2013. Kete vit ka filluar investimi për shtesë kati, ku gjatë 2017 është bërë vetëm vlerësimi i strukturës së godinës nga e cila kanë dalë nevoja për përf forcime në strukturën mbajtëse

Gjithashtu, hapësirat e ambienteve te punës, ne shumë prej drejtorive jane te kufizuara dhe një pjesë e tyre janë detyruar të sistemohen në ambiente me qira, në pamundësi për të gjetur ambiente të përshtatshme shtetërore.

Për Qarkun e Tiranës gjendja paraqitet me probleme.



Tre drejtori janë të sistemuara në ambiente shtetërore, në administrim, të cilat kanë nevojë për investime, për tu bërë sa më të shfrytëzueshme.

Dy drejtori janë të sistemuara në ambiente me qira (Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë, e vendosur në Kamëz dhe Drejtoria e ALUIZNI- Tirana Rurale e vendosur në zonën e Laprakës). Marrja e këtyre ambienteve me qira, duke patur parasysh një kosto sa më të ulët në zërin shpenzime për qiranë, nuk jep mundësinë e sigurimit të kushteve optimale dhe po ashtu të kryerjes së investimeve kapitale.

Gjithashtu në ambiente me qira funksionojnë ALUIZNI Diber, Lezhe, Sarandë dhe Korçë.

ALUIZNI Berat, me një numër prej 23 punonjësish, ushtron aktivitetin në një hapësirë prej 100m<sup>2</sup>, ambiente këto jashtë kushteve teknike të punës me shumë lageshti.

ALUIZNI Lushnjë dhe Kavajë ushtrorjnë aktivitetin, në ambiente shtetërore, përkatësisht në 2 dhe 3 zyra dhe kanë nevojë emergjente për ambiente shtesë.

ALUIZNI Fier është sistemuar në ambiente shtetërore në administrim të ALUIZNI-t por që kanë nevojë për rikonstruksion dhe ndertim të rrjetit elektrik dhe informatik.

Veshtiresi të madhe kanë grupet e terrenit që verifikojnë dhe matin objektet informale. Kjo jo vetëm përse i përket largësise dhe hapësirave që mbulojnë, por sidomos për shkak të transportit. Nga 21 drejtori rajonale vetëm në 12 prej tyre ka në administrim automjete, 10 prej të cilave janë plotësisht të amortizuara.

## **D. VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM.**

### ***1. Rezultatet e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm***

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", Sektori i Auditit të Brendshëm, ka synuar të përfshijë ato subjekte, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ato ushtrorjnë veprimtarinë administrative.

Veprimtaria audituese është orientuar në auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë në mënyrë efçente dhe me kosto efektive, me qëllimin final arritjen e objektivave.

Sipas Planit Vjetor të Auditimit të vitit 2017, (nr.7522, datë 20.10.2016) miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, u parashikua kryerja e 15 auditimeve të plota. Efektivisht në 2017, janë realizuar 4 auditime të plota dhe 23 auditime tematike, janë evaduar 3 (katër) dosje auditimi dhe 1 (një) është në proces evadimi. Përse i përket realizimit jo të plotë të programit vjetor të auditimit, kjo ka qenë rrjedhojë e auditimeve që ka ushtruar Kontrolli i Lartë i Shtetit, në drejtoritë e programuara të auditoheshin nga A.B. i ALUIZNI-t, si dhe vlerësimit të njëjësive që përcaktohen me risk më të lartë dhe me mos realizim të objektivave. Për këto arsye është bërë dhe shmangie nga plani vjetor i auditimit për vitin 2017.

Proçesi i planifikimit ka vijuar të përmirësohet, duke shfrytëzuar eksperiencat më të mira, si dhe duke respektuar me profesionalizëm standartet e auditimit të brendshëm në fushën e planifikimit.

Sektori i Auditit të Brendshëm e ka orientuar përdorimin e burimeve të auditimit drejt fushave me risk të lartë, duke orientuar njësinë drejt përmbushjes së objektivave me



kosto sa më të ulët, si dhe me qëllim kontribuimin në arritjen e objektivave dhe programeve strategjike të sistemit financiar publik.

Sektori i Auditimit të Brendshëm do të vijojë të përmirësojë efikasitetin e punës dhe do rrisë asistencën profesionale në ndihmë të përmirësimit të drejtimit dhe shtimit të vlerës së ALUIZNI-t dhe të njësive në vartësi të saj, duke planifikuar për auditim ato struktura varësie, aktivitete apo fusha me risk të lartë, pa lënë mënjanë edhe strukturat e tjera të varësisë.

Gjatë vitit 2017, janë shqyrtuar një numër i lartë ankesash nga qytetarët, ku për një pjesë e tyre është bërë dhe verifikimin në terren i objekteve pa leje, ku janë hartuar 67 **Akt-Konstatime**, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse.

Gjatë vitit 2017, janë shqyrtuar një numër i lartë ankesash nga qytetarët në portalin [www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al). Ka patur denoncime për 157 raste të reja. Nga të cilat janë zgjidhur 68 raste; janë refuzuar 53 raste; janë në proces 36 raste, të cilat kërkojnë në shumicën e tyre skualifikime nga proçesi i legalizimeve.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë entiteteve të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për periudhën e 12 mujore të vitit 2017, janë dhënë rekomandime, të cilat prekin sistemin e pagave, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemet e tjera sipas misionit, qëllimit dhe ligjit organik përkatës si dhe sistemin e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar. Këto rekomandime janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim, në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare me synimin për të ulur mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Procesi i monitorimit dhe sigurimi i cilësisë së AB në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t ka qenë e një niveli të kënaqshëm gjatë hartimit dhe mbajtjes së programit kemi siguruar që cilësia e auditimeve të kryera ka qenë e një niveli të mirë të specialistëve të këtij sektori. Auditimi i brendshëm është kryer në bazë të standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit të brendshëm, dhe manualit të Auditit të Brendshëm.

Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është edhe monitorimi dhe rishikimi i jashtëm i veprimtarisë audituese ku Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ka kryer trajnimet e përvitshme dhe të vazhdueshme në lidhje me standardet e AB si dhe të kontrollit të brendshëm.